



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

Nr. / Br 37646 / 25

Nr. i fq. / Br. st -

Data: / Datum 31.07.2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn-Municipality of Vushtrri

**Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e Këshillit Lokal Stanoc i
Epërm**

Korrik 2025

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026, i mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Stanoc i Epërm.

Vendi: Shkolla “Migjeni” në Stanoc të Epërm

Ora: 19:30

Data: 25.06.2025

Të pranishëm nga Komuna ishin asamblistët Faton Hyseni dhe Ymer Haradinaj, si dhe Mirjeta Duraku, nga Zyra për Informim.

Faton Hyseni, asamblist, hapi takimin me qytetarë dhe tha se në këtë takim do të mblidhen kërkesat e qytetarëve të Këshillit Lokal Stanoc i Epërm për përfshirje në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026.

Qytetarëve të pranishëm në këtë dëgjim ju është shpërndarë material informues për buxhetin e vitit 2026.

Më pas, fjalën e morën edhe banorët e pranishëm, të cilët paraqitën kërkesat e tyre.

Hysen Cakaj, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi që të rregullohen rrugët “Hajrullah Cakaj”, “Bahri Cakaj” (aneks), “Afet Cakaj” dhe “Ragip Cakaj”.

Skender Pronaj, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi që të rregullohet kanalizimi për 5-6 shtëpi të lagjja Haxhaj dhe Prronaj.

Hasan Maloku, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi që të rregullohen dritat në rrugën “Dalip Maloku”, pastaj të vazhdohet rregullimi i trotuarit nga kanali i Ibër-Lepencit deri te lagjja Ajvazi.

Faton Hyseni, që është edhe banor i fshatit Stanoc i Epërm, tha se disa familje kanë mungesë të ujit të pijshëm në lagjen Bllaca, disa familje të lagjes Kosumi, Haradinaj dhe Ajvazi. Mundësisht, sa më shpejt të sigurohet uji i pijshëm.

Kërkesat e tjera:

1. Të rregullohet trotuari në rrugën “Sadik Mala” (300 m).
2. Në rrugën “Arbenita Terakaj” të bëhet ndriçimi dhe të riparohet kanalizimi.
3. Në rrugën “Skender Bllaca” të vazhdohet rregullimi i trotuarit dhe të riparohet ndriçimi.
4. Në rrugën “Ylber Haradinaj” të rregullohet ndriçimi dhe dy rrugica të shtrohen me zhavorr.

Të rregullohen këto rrugë me zhavorr:

1. Rruga “Vjena” – 400 m
2. Rruga “Jeton Haradinaj” – 200 m
3. Rruga “Ekrem Cakaj” – 100 m
4. Rruga “Hajrullah Cakaj” – 100 m

5. Rruga “Feim Haradinaj” – 20 m
6. Rruga “Shefqet Haradinaj” – 30 m
7. Rruga “Sami Bllaca” – 150 m
8. Rruga “Remzi Shala” – 80 m
9. Rruga “Besim Shala” – 80 m
10. Rruga “Nexhat Shala” – 50 m

Në këtë takim me qytetarë kanë marrë pjesë 13 banorë.

Procesmbajtëse:

Mirjeta Duraku







Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2026

Vendi: SHFMU "Migjeni" Stanoc i Epërm

Datë: 25.06.2025

Ora: 19:30

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Fehmi Shala	[Signature]	Stanoc i Epërm
2	Skender Proraj	[Signature]	STANOVCI Epërm
3	Sabedin Proraj	[Signature]	Stanoc
4	Hysem Canaj	[Signature]	Stanoc
5	HASAN MALOKU	[Signature]	Stanoc
6	AJET CAKAJ	[Signature]	STANOC
7	VEDAT HAJRUDINAJ	[Signature]	STANOC
8	Artem Haradinaj	[Signature]	Stanoc
9	FEIM HAJRUDINAJ	[Signature]	Stanoc
10	SAMI BILACA	[Signature]	STANOC
11	FIATOH HASSEJ	[Signature]	STANOC
12	Ymer Haradinaj	[Signature]	Stanoc i Epërm
13	PAJF HAJRUDINAJ	[Signature]	[Signature]
14			
15			